



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT MJEDISOR

Nr. 6955 Prot.

Tiranë, më 24.8. 2018

Nr. Identifikimi 618

Vendimi 38

DEKLARATË MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore” dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

VENDOSI:

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

Person juridik: “AGI KONS” sh.p.k.
Nr. NIPT-i: K21622001M
Adresa e selisë: Kodra e Diellit II, Godinë e kombinuar 4 kat+ 1 kat nëntokë, nr. pasurie 51/159, Farkë, Selitë, Tiranë
Personi përgjegjës: Alban Çinari


Për të zhvilluar projektin: “**Godinë banimi e shërbimesh 5 kate dhe 4 kat parkim nëntokë**” Aplikimi është bërë referuar Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 10 440” , datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, Neni 9, “Projektet që i nënshtrohen procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis”, Pika 1. Procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis i nënshtrohen: b) projektet, për të cilat vendimi i AKM-së parashikon nevojën e zbatimit të kësaj procedure

Vendndodhja: Rruga e Zallit, Selitë, Fark, Tiranë

Sipërfaqja e pronës: 22 330 m²

Sipërfaqja e ndërtimit: 7 580 m²

(Bashkangjitur vendimit, gjeni aneksin me hartën topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit)



Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

Miratimi i lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

**1. Qëndrimin e Ministrisë dhe sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi:
Drejtoritë Teknike të Ministrisë shprehën:**

Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr. 10440 / 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, në rast se zgjidhni pikën "a" apo "b" të referencës ligjore së sipërcituar, në Deklaratën Mjedisore të vendosen kushte të detajuara përsa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve, etj. të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

2. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:

Konsultimi me publikun: Morën pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës, përfaqësues nga Pushteti Vendor si dhe nga Drejtoria Rajonale e Mjedisit dhe përfaqësues nga studio mjedisore. Nuk pati ndonjë shqetësim nga komuniteti për zhvillimin e këtij aktiviteti. Në takim është prezantuar projekti, janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilat do të merren parasysh nga ana e investitorëve, gjatë kohës së shfrytëzimit. Nga ana e investitoreve iu siguria të pranishmeve që do të merren të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, duke mos cënuar jetën e banorëve.

• **Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi;**


Zhvillimi i aktivitetit është në përputhje me:

***Planin e Përgjithshëm Vendor, Bashkia Tiranë, Vendim Nr.1, datë: 14.04.2017 i KKT-së.**

3. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme:

- 3.1. Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT / Bashkia / Njësi Administrative) dhe akteve ligjore në fuqi.
- 3.2. Ky Vendim është i vlefshëm pasi subjekti të marrë miratim nga institucionet përkatëse për këtë lloj aktiviteti.
- 3.3. Të kryhen punime vetëm në gjurmët e projektit të propozuar.
- 3.4. Në rast se gjatë punimeve shfaqen elemente të tilla si: objekte kulti, gjurmë arkeologjike, burime ujore etj, subjekti të ndërpresë punimet dhe të lajmërojë urgjentisht organet kompetente.

- 3.5. Në rast se kjo sipërfaqe prek fond pyjor, subjekti duhet të bëjë kërkesë pranë institucioneve përkatëse për heqje nga fondi pyjor.
- 3.6. Të merren masa për të parandaluar rëniet e zjarrit gjatë realizimit të punimeve në terren dhe të sigurohen mjetet e nevojshme të ndërhyrjes në rast të rënies së zjarrit (zjarrfikse të lëvizshme, bombula me shkumë, etj);
- 3.7. Niveli i zhurmave gjatë procesit të jetë brenda normave të lejuara dhe të punohet në orare kur shqetësimi i banorëve dhe zonave përreth të jetë me ndikim sa më të ulët
- 3.8. Të bëhet rrethimi i zonës ku do të realizohen punimet, për të shmangur hyrjet e pa autorizuara.
- 3.9. Operacionet për zbatimin e projektit (ndërtimi) të përdorin sa më shumë të jetë e mundur infrastrukturën egzistuese të transportit (rrugën dhe rrjetet egzistuese).
- 3.10. Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikantëve e të hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve të subjektit.
- 3.11. Të bëhet pastrimi i mjeteve të punës para daljes nga kantieri i ndërtimit për të mos shkaktuar ndotje në mjedis.
- 3.12. Subjekti të kujdeset për menaxhimin e mbetjeve të krijuara nga veprimtaria, ato të ambalazhimit dhe ndërtimit, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimet e caktura nga njësia vendore. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.
- 3.13. Të mos hidhet asnjë mbetje e ngurtë ose e lëngët në mjedisin ujqor dhe atë tokësor.
- 3.14. Subjekti të realizojë në mënyrë të menjëhershme çdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tij.
- 3.15. Kompania të ndjekë me përpikmëri projektin teknik për të evituar erozionin e tokës, me qëllim ruajtjen e cilësisë së ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore.
- 3.16. Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.
- 3.17. Furnizimi me ujë të pijshëm të bëhet në tubacionin kryesor, me miratimin të organeve kompetente.
- 3.18. Furnizimin me energji elektrike të bëhet konform kërkesave e me miratimin të organeve kompetente.
- 3.19. Në raste aksidentesh ose defektesh teknologjike që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në DRM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga ky aksident.
- 3.20. Para fillimit të veprimtarisë të trajnohen të gjithë punëtorët e subjektit si dhe të njihen me termat dhe kushtet e sipërcituara në Vendim.
- 3.21. Të kryhet mirëmbajta dhe gjelbërimi në mënyrë të vazhdueshme i mjediseve përreth objekteve duke ruajtur një imazh të këndshëm dhe minimizuar ndikimet në mjedis.
- 3.22. Kompania duhet të respektojë të gjitha kushtet teknike të ndërtimit sipas akteve ligjore dhe nën ligjore në fuqi.
- 3.23. Kompania duhet të respektojë gjithashtu edhe kushtet e vendosura në raportin e VNM-së që është paraqitur në aplikim si dhe të ketë parasysh ligjin Ligjin Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.
- 3.24. Në përfundim të punimeve, të sillet pranë AKM një raport mbi gjendjen e mjedisit të shoqëruar me foto dhe mbi punimet rehabilituese gjatë gjithë vijës së projektit.



3.25. Në rast se gjatë zhvillimit të aktivitetit do të ketë efekte në mjedis, në bazë të Ligjit nr. 60/2014 datë 19.6.2014, “Për një ndryshim në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, të ndryshuar, Shtojca I, duhet t’i nënshtrohet procedurave për pajisje me Leje Mjedisore.

Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”, ky subjekt ka kryer pagesën 50.000 lekë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I AKM

EDISON KONOMI



**MINISTRI
BLENDI KLOSI**